



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

06Nr ^{350/01-15165} 721
Dt.02.06.2021

Drejtori i DUKMM-së i Komunës së Kaçanikut në bazë të të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke u bazuar në kërkesën 06.Nr.351/02-2532/21 të datës 26.01.2021 e “2 Korriku” Sh.P.K., merr këtë:

VENDIM

1. Për emërimin e anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e ligjshmërisë së tërë dokumentacionit të “2 Korriku” Sh.P.K. me përbërje prej:
 - 1.1. Zekir Selimi, jurist, zyrtar në DUKMM
 - 1.2. Ilir Krivanjeva- jurist, zyrtar në DUKMM
 - 1.3. Mentor Shehu-inxhinier i gjeodezisë, zyrtar në DUKMM,
2. Anëtarët e komisionit duhet të shqyrtojnë të gjitha dokumentat, duke përfshirë Pëlqimin e Komunës dhe dokumentacionit të plotë të kompanisë.
3. Komisioni duhet të japë rekomandim të qartë me shkrim për veprimet që duhet të ndërmerren tash e tutje.
4. Komisioni do të pajiset me tërë dokumentacionin ekzistues dhe me tërë komunikimet me Ministrinë përkatëse.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës, DUKMM
2. Anëtarëve të Komisionit, dhe
3. Arkivit.



Drejtori i DUKMM-së
Ukshin Callaku



01.Nr 104/e2-12437/21
Kaçanik, 05.06.2021

Në mbështetje të nenit 17 pika h dhe pika r , nenit 58 pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 9 të Rregullores për Përcaktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencionëve dhe Transfereve si dhe në bazë të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

1. LEJOHET ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shumë prej 47.500.00 euro për vitin 2021.
2. U lejohe shuma e mjeteve financiare ekipeve sportive dhe shoqatave rinore si në vijim:
 - 2.1 KF Lepenci shuma 15.000.00 euro
 - 2.2 KB Kaçaniku shuma 2.800.00 euro
 - 2.3 KH Lepenci shuma 2.800.00 euro
 - 2.4 KV-M Lepenci shuma 1.800.00 euro
 - 2.5 KV-F Lepenci shuma 1.800.00 euro
 - 2.6 KFF Bazeli shuma 2.500.00 euro
 - 2.7 Pedagogët e kulturës fizike shuma 1.200.00 euro
 - 2.8 TAEKËONDO shuma 1.500.00 euro
 - 2.9 SH.B Alpiniste "Kaçaniku 2015" shuma 1.000.00 euro
 - 2.10 KVRL shuma 1.400.00 euro
 - 2.11 Motocross Kaçaniku shuma 1.000.00 euro
 - 2.12 Klubi i Mundjes Kaçaniku 1.200.00 euro
 - 2.13 SH.P.S.R Trofta Lepenci shuma 1.000.00 euro
 - 2.14 Fondacioni Bonevet shuma 2.000.00 euro

3. U lejohet shuma e mjeteve financiare Shoqërive Kulturo-Artistike si në vijim:
- 3.1 SHKA "Tingujt e Vendlindjes" shuma 3.500.00 euro
 - 3.2 SHKA "Gryka e Kaçanikut" shuma 3.500.00 euro
 - 3.3 Qendra Kulturore Kaçaniku shuma 3.500.00 euro
4. Mjetet Buxhetore nga ky vendim sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.
5. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës si dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
7. Vendimi i dërgohet Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit si dhe arkivit komunal:

Kryetari i Komunës

